

Përmbledhje

Aktiviteti ekonomik në eurozonë ka vazhduar rikuperimin përgjatë vitit 2016, përderisa në linjë me pritjet e BQE-së, shkalla e inflacionit ka shënuar rritje graduale. Përmirësimi i kushteve të financimit, si rezultat i politikave ekspansioniste dhe masave jokonvencionale të ndërmarra nga BQE, si dhe përmirësimi të kushteve në tregun e punës dhe çmimeve të ulëta të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare kanë ndikuar në rritjen e aktivitetit ekonomik në eurozonë. Përforsimi i kërkesës në eurozonë është reflektuar pozitivisht në zhvillimet ekonomike të vendeve në Ballkanin Perëndimor, që u karakterizuan me rritje të eksporteve dhe investimeve.

Ngjashëm me eurozonën dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, rritja e aktivitetit ekonomik në Kosovë gjatë vitit 2016 është nxitur kryesisht nga përforsimi i kërkesës së brendshme, gjegjësisht nga rritja e konsumit dhe investimeve. Sipas vlerësimeve të ASK-së, përgjatë katër tremujorëve të vitit 2016, ekonomia e Kosovës është karakterizuar me një rritje mesatare të BPV-së prej 3.4 përqind.

Gjatë vitit 2016, çmimet në Kosovë kanë qenë relativisht stabile, me një rritje mesatare të IÇK-së prej 0.3 përqind. Në këtë periudhë, me rënie u karakterizuan indeksi i çmimeve të importit dhe prodhimit.

Spektori fiskal u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Në viti 2016, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 61.1 milionë euro, krahasuar me deficitin prej 111.4 milionë euro në vitin 2015.

Bilanci i pagesave në Kosovë shënoi rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale në vitin 2016, kryesisht si pasojë e rënies së eksportit të mallrave (4.8 përqind) dhe rritjes së importit (5.9 përqind). Gjithashtu, rënia e të ardhurave nga kompensimi i

punëtorëve ndikoi në përkeqësimin e llogarisë rrjedhëse. Në anën tjetër, rritja e eksportit dhe rënia e importit të shërbimeve ndikoi në rritjen e bilancit pozitiv të llogarisë së shërbimeve. Sa i përket llogarisë financiare, investimet e huaja direkte edhe gjatë tremujorit të fundit të vitit 2016 vazhduan të shënojnë vlera më të ulëta në krahasim me vitin paraprak.

Spektori bankar gjatë vitit 2016 u karakterizua me rritje të aktivitetit kredidhënës (10.4 përqind), kryesisht si rezultat i përmirësimi të kushteve të kreditimit nga ana e bankave dhe rritjes së kërkesës për kredi. Rritja e kreditimit vazhdon të financohet qëndrueshëm nga depozitat e mbledhura brenda ekonomisë së vendit, të cilat shënuan një rritje vjetore prej 7.2 përqind.

Norma mesatare e interesit në kredi në dhjetor 2016 u zvogëluar në 7.2 përqind, përderisa norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje në 1.2 përqind.

Norma e kredive joperformuese vazhdoi të zvogëlohet edhe gjatë tremujorit të katërt, duke zbritur në 4.9 përqind në dhjetor 2016, përderisa edhe treguesit tjerë të shëndetit financiar vazhduan të kenë gjendje të kënaqshme.

Me rritje të aktivitetit u karakterizuan edhe segmentet tjera të sistemit financiar, si sektori pensional, sektori i sigurimeve dhe sektori mikrofinanciar. Për sa i përket performancës, vërehet përmirësim më i theksuar te sektori mikrofinanciar, përderisa edhe sektori pensional realizoi kthim pozitiv nga investimet. Në anën tjetër, sektori i sigurimeve gjatë kësaj periudhe shënoi thellim të humbjes.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE -----	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor -----	04
Ekonomia e Kosovës -----	06
Sektori Real-----	06
Regjistri i bizneseve -----	07
Sektori Fiskal-----	08
Sektori i Jashtëm-----	09
Sistemi Financiar-----	11
Sektori Bankar-----	11
Sektori Pensional-----	18
Sektori i Sigurimeve-----	19
Sektori Mikrofinanciar-----	21
Tregu i Letrave me Vlerë-----	24

GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë-----	04
Figura 2. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së-----	05
Figura 3. Norma e inflacionit-----	06
Figura 4. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë-----	06
Figura 5. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit-----	07
Figura 6. Lëvizja e çmimeve të importit-----	07
Figura 7. Lëvizja e çmimeve të prodhimit-----	07
Figura 8. Regjistri i bizneseve-----	07
Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja-----	08
Figura 10. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar-----	09
Figura 11. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	09
Figura 12. Struktura e importeve sipas kategorive-----	10
Figura 13. Remitencat-----	10
Figura 14. Struktura e investimeve të huaja direkte-----	11
Figura 15. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës-----	11
Figura 16. Asetet e bankave komerciale-----	11
Figura 17. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave-----	12

Figura 18. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare-----	13
Figura 19. Kreditë sipas sektorëve ekonomik -----	13
Figura 20. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik -----	13
Figura 21. Depozitat -----	14
Figura 22. Struktura e depozitave -----	14
Figura 23. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita -----	15
Figura 24. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve-----	15
Figura 25. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	15
Figura 26. Norma mesatare e interesit në depozita -----	16
Figura 27. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje -----	16
Figura 28. Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare -----	16
Figura 29. Profiti neto i sektorit bankar-----	17
Figura 30. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar -----	17
Figura 31. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	17
Figura 32. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve -----	18
Figura 33. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës -----	18
Figura 34. Asetet e sektorit pensional -----	19
Figura 35. Investimet e FKPK-së -----	19
Figura 36. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	20
Figura 37. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	20
Figura 38. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	21
Figura 39. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, rritja vjetore e kredive-----	21
Figura 40. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve -----	22
Figura 41. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar-----	22
Figura 42. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	22
Figura 43. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	23
Figura 44. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	23
Figura 45. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	23
Figura 46. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore -----	23
Figura 47. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	24
Figura 48. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit-----	25
Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së -----	05
Tabela 2. Numri dhe vlera e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës -----	24
Tabela 3. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	26

SHKURTESAT:


APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CHF	Franku Zvicërran
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit
KJP	Kreditë Jopërfomuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
USD	Dollari Amerikan
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Aktiviteti ekonomik në eurozonë ka vazhduar rikuperimin edhe në tremujorin e katërt të vitit 2016, përderisa në linjë me pritjet e BQE-së, shkalla e inflacionit ka shënuar rritje graduale. Ekonomia e eurozonës ka vazhduar të shfaqë qëndrueshmëri ndaj efekteve anësore të rritjes së ngadalshme të ekonomisë globale dhe pasigurive politike, përderisa politikat ekspansioniste dhe masat jokonvencionale të ndërmarra nga BQE në kuadër të programit të lehtësimit sasior kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve të financimit në eurozonë. Në TM4 2016, rritja vjetore e BPV-së në eurozonë u ngrit lehtësisht në 1.7 përqind nga 1.6 përqind në vitin paraprak, rritje e mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme (figura 1).

Rritja ekonomike në eurozonë në TM4 2016 kundrejt periudhës së njëjtë në vitin paraprak u mbështet kryesisht nga ekonomitë qendrore të eurozonës si Gjermania (1.8 përqind), Franca (1.1 përqind), Holanda (2.5 përqind), Italia (1.1 përqind) dhe Spanja (3.0 përqind).

Figura 1. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë



Burimi: Eurostat (2017)

Norma e inflacionit në eurozonë vazhdoi të jetë nën objektivin e BQE-së, megjithatë vlerësohet të ketë arritur nivelin jashtë së ashtuquajturës 'zonë rreziku'. Në dhjetor norma e inflacionit ishte 1.1 përqind, ndërsa shkalla mesatare e inflacionit gjatë vitit 2016 ishte 0.2 përqind.


Masat e reja të ndërmarra nga BQE-ja në mars 2016 në kuadër të programit të lehtësimit sasior kishin si qëllim parësor evitimin e deflacionit dhe rikthimin e shkallës së inflacionit më afër caktuar prej 2 përqind. Megjithatë, ndikimi i politikave ekspansioniste monetare në nivelin e çmimeve në eurozonë ka rezultuar të jetë i kufizuar, kryesisht si pasojë e rënies së theksuar të çmimeve të energjisë gjatë vitit 2016. Projeksionet e BQE-së për vitin 2017, sugjerojnë se shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë pritet të jetë 1.4 përqind.

Lansimi i programit të gjerë stimulues që nga marsi i vitit 2016 ka ndikuar drejtpërdrejtë në rënien e mëtutjeshme të normave 1 mujore dhe 12 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor (figura 2). Gjithashtu, BQE-ja ka vazhduar të mbajë normën e interesit në operacionet kryesore të rifinancimit në zero përqind.

Rikuperimi i aktivitetit kreditues në eurozonë ka vazhduar edhe në tremujorin e katërt të vitit 2016, i mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës për kredi të të gjitha kategorive si dhe përmirësimi i kushteve të kreditimit. Megjithatë në shumicën e bankave të vendeve të eurozonës standardet kreditore gjatë TM4 2016 mbetën të pandryshuara, ndërsa Holanda raportoi të ketë shtrënguar standardet kreditore për

kreditë ndaj ndërmarrjeve. Eurozona u karakterizua me një rritje të kreditimit prej rreth 2.4 përqind në TM4 2016, ku me rritje më të shpejtë prej 1.9 përqind u karakterizuan ekonomitë familjare, përdërisa kreditë për ndërmarrjet shënuan rritje prej 0.6 përqind. Rritja e të ardhurave në dispozicion në eurozonë në këtë periudhë si dhe niveli ende i ulët i investimeve mund të kenë ndikuar në rritjen e depozitave të rezidentëve në sektorin bankar në vendet e eurozonës. Rritje më të lartë të depozitave në këtë periudhë shënuan ndërmarrjet (6.2 përqind në TM4 2016), pasuar nga depozitat e ekonomive familjare (4.0 përqind).

Figura 2. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së



Burimi: Euribor (2017) dhe BQE (2017)

Gjatë TM4 2016, performanca e aktivitetit ekonomik në Ballkanin Perëndimor vazhdoi të përforcohet. Rritja e kërkesës në eurozonë, si partner kryesor tregtar për vendet në Ballkanin Perëndimor, u përkthye në përmirësim të pozicionit të neto eksporteve në disa vende të rajonit. Rritja e eksporteve, së bashku me rritjen e investimeve të huaja dhe konsumit të brendshëm, paraqitën kontribues të rëndësishëm në rritjen mesatare prej 3.3 përqind të BPV-së në Ballkanin Perëndimor në TM4 2016 (tabela 1).

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së

Përshkrimi	2013	2014	2015	2016
Bosnja dhe Hercegovina	2.4	1.1	3.2	3.0
Kosova	3.4	1.2	4.1	3.6
Mali i Zi	3.5	1.8	3.2	5.1
Maqedonia	2.9	3.5	3.7	2.2
Serbia	2.6	-1.8	0.7	2.5
Shqipëria	1.0	1.8	2.8	3.4

Burimi: WEO (2017) dhe vlerësimi i BQK-së për Kosovën gjatë vitit 2016.

Ngjashëm me eurozonën, vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizuan me presione të dobëta inflacioniste, që kryesisht i atribuohen zhvillimeve të çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Në vitin 2016, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia u përballën me deflacion (0.7 përkatësisht 0.2 përqind), përdërisa Mali i Zi, Serbia, dhe Shqipëria regjistruan një shkallë mesatare të inflacionit prej 0.1, 1.1 përkatësisht 1.3 përqind.

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar vendet e rajonit u karakterizuan me rritje të aktivitetit kreditues në këtë periudhë ku rritjen më të lartë e kishte Kosova (10.4 përqind), Serbia (6.1 përqind) dhe Mali i Zi (1.3 përqind), përdërisa rritje më të ulët shënoi Maqedonia me 0.7 përqind. Vendet e rajonit raportuan edhe për rritje të depozitave, ku Serbia shënoi rritjen më të lartë të depozitave deri në dhjetor 2016 (11.5 përqind) dhe Mali i Zi (9.4 përqind), përdërisa rritjen më të ulët shënoi Shqipëria (5.4 përqind).

Deri në dhjetor, euro është zhvlerësuar lehtësisht kundrejt dollarit amerikan ndërsa është vlerësuar kundrejt valutave tjera të mëdha si sterlina britanike dhe franku zviceran. Gjatë kësaj periudhe, norma mesatare e këmbimit të euros ndaj dollarit amerikan

është zhvlerësuar për 0.1 përqind, ndërsa ndaj frankës zvicerane dhe sterlinës britanike është vlerësuar për 2.2 përkatësisht 12.0 përqind. Në kuadër të monedhave të rajonit, euro është vlerësuar kundrejt denarit maqedon dhe dinarit serb për 0.01 përkatësisht 2.0 përqind, përderisa është zhvlerësuar ndaj lekut shqiptar për 1.7 përqind.

Ekonomia e Kosovës


Sektori real

Ekonomia e Kosovës, sipas vlerësimeve të ASK-së, ka shënuar rritje prej 3.4 përqind në vitin 2016, gjë që është në linjë me parashikimet e BQK-së në fillim të vitit 2016. Kjo rritje e aktivitetit ekonomik është gjeneruar kryesisht nga rritja e investimeve prej 10.4 përqind si dhe rritja e konsumit prej 2.9 përqind, përderisa neto eksportet vlerësohet të jenë karakterizuar me thellim të konsiderueshëm të deficitit prej 8.0 përqind në terma real. Rritja reale e ekonomisë së Kosovës është mbështetur kryesisht nga rritja në aktivitetin e sektorit të bujqësisë (7.6 përqind), tregtisë (4.8 përqind) dhe aktiviteteve financiare (12.4 përqind). Ndërsa, rënie reale vlerësohet të jetë shënuar tek afarizmi me pasuri të patundshme (1.5 përqind), industria përpunuese (1.1 përqind) dhe administrimi publik (0.4 përqind).

Çmimet

Çmimet gjatë vitit 2016 kanë qenë relativisht stabile. IÇK shënoi rritje mesatare prej 0.3 përqind (figura 3).


Figura 3. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2017)


Sa i përket komponentëve të IÇK-së, me rritje u karakterizuan çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit (8.1 përqind), pasuar nga çmimet e veshmbathjes (2.7 përqind). Në anën tjetër, rënie e çmimeve është shënuar kryesisht te rryma, gazi e lëndët tjera djegëse (2.3 përqind) si dhe shërbimet e transportit (1.9 përqind). Me rënie prej 0.1 përqind u karakterizuan edhe çmimet e ushqimit, që përfaqësojnë rreth 33.9 përqind të shportës së konsumatorit kosovar (figura 4).

Figura 4. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2017)


Figura 5. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2017)

Indeksi i çmimeve të importit shënoi rënie vjetore prej 2.6 përqind (figura 5). Çmimet e produkteve minerale, të cilat janë kategoria kryesore e indeksit të çmimeve të importit, shënuan rënie më të lartë (12.3 përqind), ndërsa çmimet e vajrave ushqyese shënuan rritjen më të lartë të çmimeve (5.7 përqind) (figura 6).


Figura 6. Lëvizja e çmimeve të importit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2017)

Indeksi i çmimeve të prodhimit u karakterizua me rënie prej 0.1 përqind. Në këtë periudhë, me rënie u karakterizuan kryesisht çmimet e prodhimit të drurit dhe mobileve. Ndërsa, me rritje të çmimeve u karakterizuan energjia elektrike, prodhimi i lëkurës, metaleve, etj. (figura 7).

Figura 7. Lëvizja e çmimeve të prodhimit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2017)

Regjistri i bizneseve

Sa i përket regjistrimit të bizneseve, në vitin 2016 është shënuar rritje e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe po ashtu rritje e numrit të ndërmarrjeve të mbyllura. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte 10,424 apo 591 ndërmarrje më shumë se sa në vitin paraprak, ndërsa u mbyllën 2,376 ndërmarrje apo 171 ndërmarrje më shumë se sa në vitin paraprak (figura 8).

Figura 8. Regjistri i bizneseve, jo kumulative




Burimi: ASK (2017)

Numri më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara vazhdon të jetë i koncentruar në sektorin e tregtisë me 2,738 ndërmarrje të reja, pasuar nga sektori i

prodhimtarisë me 1,181 ndërmarrje, bujqësisë me 1,090 ndërmarrje dhe hotelerisë me 1,017 ndërmarrje (figura 9).

Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Krahasuar me vitin 2015, pothuajse në të gjithë sektorët është shënuar rritje e ndërmarrjeve të regjistruara. Në sektorin e bujqësisë është shënuar rritja më e lartë e ndërmarrjeve të regjistruara prej 145 ndërmarrje më shumë, pasuar nga sektori i prodhimit që u karakterizua me 134 ndërmarrje më shumë. Sektorët që shënuan numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara ishin sektori i tregtisë dhe patundshmërive (165 përkatësisht 16 ndërmarrje më pak).

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore¹ në vitin 2016 arritën vlerën neto prej 1.60 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore rreth 9.6 përqind. Në të njëjtën periudhë, shpenzimet buxhetore² arritën vlerën prej 1.66 miliardë euro që paraqet një rritje vjetore rreth 5.7 përqind.

¹ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

² Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.

Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 61.1 milionë euro krahasuar me deficitin prej 111.4 milionë euro në vitin 2015.

Sa i përket llojit të tatimeve, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore direkte të cilat arritën vlerën prej 232.1 milionë euro (17.4 përqind rritje), pasuar nga të hyrat tatimore indirekte të cilat arritën vlerën prej 1.2 miliardë euro (11.2 përqind rritje), ndërsa të hyrat jo-tatimore shënuan rënie prej 8.3 përqind dhe arritën vlerën prej 175.3 milionë euro.

Sa i përket shpenzimeve, pothuajse të gjitha kategoritë u karakterizuan me rritje përveç mallrave dhe shërbimeve të cilat shënuan rënie. Shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje shënuan rritje prej 3.6 përqind dhe arritën vlerën prej 543.7 milionë euro. Subvencionet dhe transferet po ashtu shënuan rritje për 13.5 përqind dhe arritën vlerën prej 474.7 milionë euro. Investimet kapitale, të cilat përfaqësojnë rreth 26.8 përqind të gjithë shpenzimeve buxhetore, shënuan rritje prej 9.8 përqind dhe arritën vlerën 443.6 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rënie për 1.3 përqind dhe arritën vlerën prej 202.8 milionë euro.

Borxhi publik arriti në 852.7 milionë euro në vitin 2016, që tregon për një rritje vjetore prej 13.9 përqind. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në rreth 14.5 përqind, nga 13.0 përqind sa ishte në vitin paraprak. Kjo rritje e borxhit publik i atribuohet kryesisht rritjes së borxhit të brendshëm prej 26.8 përqind (i cili ka arritur në 479.0 milionë euro), ndërkohë që borxhi i jashtëm publik ka shënuar një ngritje të lehtë prej 0.7 përqind duke arritur në 373.8


milionë euro. Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm publik në gjithsej borxhin e brendshëm është zvogëluar në 43.8 përqind nga 59.6 përqind sa ishte në vitin 2015.

Sektori i Jashtëm

Gjatë vitit 2016, deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 534.6 milionë euro, krahasuar me deficitin prej 471.4 milionë euro sa ishte në vitin paraprak. Kjo rritje e deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale i atribuohet rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarisë së të ardhurave parësore. Në anën tjetër, bilancet pozitive të shërbimeve dhe llogarisë së të ardhurave dytësore shënuan rritje.

Deficiti në tregtinë e mallrave u karakterizua me një rritje vjetore prej 7.4 përqind në vitin 2016, si pasojë e rënies së eksporteve dhe rritjes së importeve. Eksporti i mallrave arriti vlerën prej 309.7 milionë euro, që përkon me një rënie vjetore prej 4.8 përqind (figura 10).³


Figura 10. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro



Burimi: ASK (2017)

Rënia e vlerës së eksportit të mallrave gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rënies së eksporteve të metaleve bazë, që njëherësh kanë edhe pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e gjithsej eksporteve të vendit (rreth 40.0 përqind) (figura 11).

Figura 11. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2017)


Rënia e vlerës së gjithsej eksporteve të metaleve bazë u zvogëluar kryesisht si pasojë e rënies së prodhimit të nikelit në ekonominë e vendit, si dhe rënies së çmimit të metaleve në tregjet ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe. Me rënie u karakterizuan edhe eksportet e tekstilit dhe artikujve të tekstilit, si dhe eksportet e makinerive dhe pajisjeve elektrike. Në anën tjetër, eksportet e produkteve minerale shënuan rritje, kryesisht si rezultat i rritjes së vlerës së eksportit të energjisë elektrike. Gjithashtu, eksportet e produkteve të plastikës dhe gomës, si dhe eksportet e pijeve dhe duhanit shënuan rritje.

Vlera e gjithsej mallrave të importuara arriti në 2.8 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.9 përqind. Në kuadër të importit të mallrave, me rritje u karakterizua importi i mjeteve të transportit, makinerive dhe pajisjeve mekanike, produkteve të plastikës dhe gomës, ushqimeve të përgatitura, etj.

³ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Në anën tjetër, importi i produkteve minerale shënoi rënie të konsiderueshme (figura 12). Rënia e vlerës së eksporteve dhe rritja e vlerës së mallrave të importuara rezultoi në zvogëlim të shkallës së mbulueshmërisë së importeve me eksporte në 11.1 përqind (12.3 përqind në vitin 2015).

Figura 12. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2017)


Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 565.0 milionë euro, një rritje kundrejt vitit paraprak prej 23.6 përqind. Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara shënoi rritje vjetore prej 9.1 përqind, duke arritur në 1.0 miliard euro. Në anën tjetër, vlera e importit të shërbimeve shënoi rënie prej 4.3 përqind dhe arriti në 473.4 milionë euro. Në kuadër të eksportit të shërbimeve, shërbimet e udhëtimit dhe shërbimet e transportit u karakterizuan me rritje vjetore prej 12.4 përkatësisht 6.6 përqind, përderisa kategoria e shërbimeve kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit shënoi rënie prej 11.6 përqind. Sa i përket importit të shërbimeve, shërbimet e transportit shënuan rënie prej 15.1 përqind ndërsa shërbimet e udhëtimit shënuan rritje prej 4.2 përqind.

Llogaria e të ardhurave parësore u karakterizua me rënie prej 12.6 përqind. Bilanci i të ardhurave nga

kompenzimi i punonjësve⁴ u zvogëlua për 5.6 përqind, ndërsa bilanci i të ardhurave të realizuara nga investimet u zvogëlua për 1.6 përqind.

Bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje për 3.2 përqind në vitin 2016, që i atribuohet nivelit më të lartë të remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, shënuan vlerën prej 691.0 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.8 përqind (figura 13).

Figura 13. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2017)


Remitencat që pranohen në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 37.1 përqind përkatësisht 22.6 përqind të gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 6.8 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë.

Investimet e Huaja Direkte (IHD) të pranuar në Kosovë arritën vlerën prej 215.9 milionë euro, që paraqet nivel më të ulët krahasuar me vlerën prej

⁴ Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qendrin e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

308.8 milionë euro të regjistruar në vitin 2015. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me zvogëlim të vlerës u karakterizuan të dy format e IHD-ve, përfshirë kapitalin dhe fondin e investimeve në aksione, si dhe investimet në instrumentet e borxhit (figura 14).

Figura 14. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2017)


Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, që përbën rreth 85.3 përqind të gjithë IHD-ve, shënoi vlerën prej 179.0 milionë euro që është për 21.5 përqind më i ulët krahasuar me vitin paraprak. Gjithashtu, IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan vlerën prej 36.9 milionë euro, një zvogëlim kundrejt vitit paraprak prej 54.3 përqind. Rënia e IHD-ve u evidentua pothuajse në të gjithë sektorët. Rënia më e theksuar ishte tek sektori i patundshmërive dhe sektori i shërbimeve financiare, sektorë që u karakterizuan me rënie vjetore prej 11.6 përkatësisht 70.5 përqind.

Sistemi Financiar

Vlera e gjithëj aseteve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 5.39 miliardë euro në vitin 2016, që përkton me një rritje vjetore prej 10.0

përqind (figura 15). Rritja e aseteve të sektorit bankar dhe atij pensional mbetën kontribuuesit kryesor në rritjen e gjithëj aseteve të sistemit financiar në vend.

Figura 15. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës




Burimi: BQK (2017)

Sektori Bankar

Asetet

Gjatë vitit 2016, asetet e sektorit bankar shënuan rritje vjetore prej 7.4 përqind, duke arritur në 3.64 miliardë euro (figura 16).

Figura 16. Asetet e bankave komerciale, ndryshimet vjetore, në milionë euro



Burimi: BQK (2017)

Zgjerimi i portofolios së kredive ishte kontribuuesi më i madh në rritjen e aseteve të sektorit bankar. Ky zgjerim reflekton rritjen e vazhdueshme të depozitave të sektorit bankar si burimi kryesor i financimit të aktivitetit kreditues në vend.

Gjatë vitit 2016, stoku i letrave me vlerë i sektorit bankar shënoi ngadalësim të rritjes në 7.8 përqind nga rritja e shënuar në vitin paraprak prej 23.3 përqind. Ky ndryshim vjen si pasojë e ngadalësimit të rritjes së investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës në 5.8 përqind (17.3 përqind në 2015), dhe investimet në letrat me vlerë të qeverive të huaja në 9.7 përqind (29.4 përqind në 2015). Ngadalësimi i rritjes së investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishte kryesisht rezultat i rritjes së konkurrencës nga akterët e tjerë të tregut si fondet pensionale, kompanitë e sigurimeve dhe institucionet e tjera publike, të cilët kanë rritur shumën e investuar në letra me vlerë të Kosovës. Po ashtu, ecuria në këtë kategori të aseteve mund t'i atribuohet edhe rritjes së mjeteve të dedikuara për kreditim, duke marrë parasysh kërkesën në rritje për kredi, normën e ulët të kredive joperformuese si dhe kthimin më të lartë nga investimi në kredi.


Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në shënoi rënie vjetore prej 6.9 përqind krahasuar me rritjen në vitin paraprak prej 9.6 përqind. Rënia e kësaj kategorie pjesërisht mund të jetë ndikuar nga zhvendosja e mjeteve drejt rritjes së kreditimit. Për më tepër, rënia e bilancit me BQK-në është ndikuar nga masa e ndërmarrë nga BQK-ja në gusht të vitit 2016 për ngarkimin me normë negative të interesit

për rezervat e bankave mbi nivelin e rezervës së detyrueshme.

Kreditë


Kreditë e sektorit bankar përshpejtuan rritjen vjetore në 10.4 përqind (figura 17). Deri në dhjetor 2016, vlera e gjithsej kredive arriti në 2.23 miliard euro. Gjatë vitit 2016, kreditimi është rritur kryesisht si rezultat i rritjes së kërkesës për kredi, si dhe përmirësimit të ofertës së kreditimit nga sektori bankar përmes uljes së normës së interesit, rritjes së shumës së kredisë së aprovuar dhe uljes së tarifave tjera të jo-interesit.

Figura 17. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave, në përqindje



Kreditë ndaj ekonomive familjare ishin kategoria që shënuan normën më të madhe të rritjes vjetore (figura 18). Ndërsa në kuadër të kredive të reja ndaj ekonomive familjare, kjo kategori shënoi rritje vjetore prej 10.8 përqind.


Figura 18. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare



Burimi: BQK (2017)

Ngjashëm me kreditë për ekonomitë familjare, edhe kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje vjetore më të përshpejtuar (figura 18). Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike vazhdon të mbetet e dominuar nga kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë, pasuar nga ato për prodhimtari dhe ndërtimtari (figura 19).

Figura 19. Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje (dhjetor 2016)




Burimi: BQK (2017)

Deri në dhjetor 2016, kreditimi i të gjithë sektorëve ekonomik shënoi rritje, përjashtuar atë të bujqësisë dhe të shërbimeve tjera financiare që u karakterizuan me rënie (0.3 përqind dhe 39.5 përqind) (figura 20). Rritje vjetore të kreditimit shënuan veçanërisht sektori i

ndërtimtarisë dhe i energjetikës (3.5 përqind dhe 6.6 përqind).

Figura 20. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2017)

Kreditë e reja ndaj ndërmarrjeve shënuan rënie vjetore prej 17.3 përqind, ku kategoria e kredive investuese shënoi rënie vjetore prej 28.2 përqind përderisa ajo e kredive jo-investuese shënoi rritje vjetore prej 4.2 përqind. Rënia e kredive të reja ndaj ndërmarrjeve e reflekton kryesisht rënien vjetore të kredive të reja ndaj sektorit të shërbimeve dhe të industrisë (20.7 përqind dhe 26.4 përqind).

Gjatë vitit 2016, përshpejtimi i aktivitetit kreditues iu atribuua kryesisht rritjes së shpejtë të kredive familjare si dhe atyre ndaj ndërmarrjeve (14.7 përqind dhe 8.3 përqind). Sa i përket strukturës së sektorëve ekonomik, ajo vazhdoi të mbetet e ngjashme me tremujorët paraprak.

Detyrimet dhe Burimet Vetanake

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, që përbëjnë 79.7 përqind të gjithsej detyrimeve dhe burimeve vetanake, duke përfaqësuar kështu burimin kryesor


të financimit të aktivitetit të sektori bankar. Pjesë përbërëse shumë të rëndësishme të kategorisë së detyrimeve vazhdojnë të mbesin edhe kategoritë e ‘obligimeve tjera’ dhe ‘bilanci me bankat komerciale’.

Kategoria e burimeve vetanake të sektorit bankar u karakterizua me rritje vjetore prej 7.1 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së theksuar të vlerës së fitimit të mbajtur në 68.7 milionë euro (24.4 milionë në dhjetor 2015).

Depozitat

Depozitat në sektorin bankar të Kosovës shënuan rritje vjetore prej 7.2 përqind, ritëm ky më i përshpejtuar krahasuar me periudhat paraprake (6.5 përqind në vitin 2015). Në vitin 2016, depozitat arritën në 2.90 miliard euro (figura 21).

Figura 21. Depozitat, në milionë euro




Burimi: BQK (2017)

Ritmi i rritjes së gjithsej depozitave diktohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare, të cilat shënuan rritje vjetore prej 8.0 përqind. Kjo kategori gjithashtu vazhdon të dominojë

strukturën e gjithsej depozitave, pasuar nga depozitat e ndërmarrjeve (figura 22).

Figura 22. Struktura e depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2017)

Në periudhën e njëjtë, depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje vjetore të përshpejtuar prej 14.5 përqind, rritje që mund të jetë ndikuar nga rritja e normës mesatare të interesit në depozitat për ndërmarrjet. Vlen të theksohet se kategoria e depozitave të transferueshme vazhdoi të rrisë pjesëmarrjen në strukturën e gjithsej depozitave në 57.9 përqind nga 54.7 përqind sa ishte në dhjetor 2015, që mund t'i atribuohet deri në një masë normës së ulët të interesit në depozita.

Depozitat vazhduan të rriten me ritëm të përshpejtuar. Struktura e depozitave vazhdon të ndryshojë në favor të depozitave të transferueshme, përderisa kategoritë e depozitave të afatizuara dhe atyre të kursimit zvogëluan pjesëmarrjen në gjithsej depozitat.


Normat e Interesit

Dallimi në mes të normës mesatare të interesit në kredi dhe asaj në depozita u ngushtua në 6.0 përqind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (6.5 përqind në 2015). Norma

mesatare e interesit në kredi në dhjetor 2016 u zvogëlua në 7.2 përqind përderisa norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje në 1.2 përqind (figura 23).

Norma mesatare e interesit në kredi në shtator 2016 u zvogëlua në 7.5 përqind përderisa norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje të lehtë në 1.0 përqind (figura 25).

Figura 23. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita




Burimi: BQK (2017)

Normat e interesit në kredi

Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve u zvogëlua në 6.8 përqind nga 7.4 përqind sa ishte në dhjetor 2015 (figura 24). Në kuadër të kësaj kategorie, normat e interesit në kreditë investuese dhe jo-investuese vazhdojnë të përcjellin trend rënës.


Figura 24. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2017)

Në dhjetor 2016, vërehet rënie më e lehtë e normave të interesit në kreditë për ndërmarrjet në krahasim me periudhat paraprake. Normat e interesit në të gjithë sektorët ekonomik shënuan rënie, disa prej tyre me ritëm më të përshpejtuar si ‘sektorët tjerë’ dhe ai i ‘shërbimeve’, për dallim nga sektori i bujqësisë dhe industrisë (figura 25).

Figura 25. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2017)

Kreditë për ekonomitë familjare gjithashtu shënuan rënie të normës mesatare të interesit në 7.9 përqind (8.4 përqind në dhjetor 2015). Në kuadër të kësaj kategorie, norma mesatare e interesit për kreditë konsumuese dhe për ato hipotekare vazhduan të ndjekin trend rënës.

Normat e interesit në depozita

Nomra mesatare e interesit në gjithsej depozitat mbeti e ngjashme krahasuar me atë të periudhës paraprake (1.2 përqind në dhjetor 2015). Rritja prej 0.1 pikë përqindje e normës së interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe rënia prej 0.1 pikë përqindje e normës së interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare bëri që norma mesatare e interesit në gjithsej depozitat të mbetet e pandryshuar (figura 26).


Figura 26. Norma mesatare e interesit në depozita



Burimi: BQK (2017)

Noma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve arriti në 1.6 përqind, një rritje e vjetore prej 0.1 pike përqindje. Më saktësisht, rritje prej 0.1 pikë përqindje shënuan normat e interesit në depozitat e kursimit dhe ato të afatizuara të ndërmarrjeve (figura 27).


Figura 27. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje, sipas kategorive



Burimi: BQK (2017)

Në anën tjetër, norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare shënoi rënie në 1.0 përqind (1.1 përqind në dhjetor 2015). Kjo rënie reflektoi kryesisht rënien e normës mesatare të interesit në depozitat e transferueshme (figura 28).

Figura 28. Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare, sipas kategorive



Burimi: BQK (2017)


Performanca e sektorit bankar⁵

Profiti i sektorit bankar shënoi rënie krahasuar me vitin paraprak, si rezultat i rënies së të hyrave dhe rritjes së shpenzimeve të sektorit. Vlera e profitit të realizuar gjatë vitit 2016 ishte 75.5

⁵ Bazuar në të dhënat e paaudituar.

milione euro, që përbën një rënie vjetore prej 20.2 përqind (figura 29).


Figura 29. Profiti neto i sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2017)

Të hyrat e sektorit bankar u karakterizuan me rënie përgjatë vitit 2016 (figura 30). Në dhjetor 2016, vlera e të hyrave arriti në 231.1 milionë euro, duke shënuar një rënie vjetore prej 3.0 përqind. Rënia e të hyrave kryesisht i atribuohet rënies së të hyrave nga interesi si pasojë e zvogëlimit të normës mesatare të interesit në kredi.

Figura 30. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar



Burimi: BQK (2017)


Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar arriti në 155.6 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 8.4 përqind (figura 30). Në rritjen e

gjithsej shpenzimeve, kontributin kryesor e kishte rritja e shpenzimeve të jo interesit.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit është përkeqësuar në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, si pasojë e rënies së të hyrave dhe rritjes së shpenzive në këtë periudhë (figura 33).

Në vitin 2016, treguesit e profitabilitetit kanë shënuar rënie si pasojë e rënies së profitit. Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) u zvogëluan në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke ndërprerë trendin rritës që kishin shënuar gjatë tri viteve të kaluara (figura 31).

Figura 31. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK (2017)


Treguesit e shëndetit financiar

Deri në dhjetor 2016, sektori bankar regjistroi rënie të kredive joperformuese dhe përmirësim të mbulueshmërisë së tyre me provizione. Niveli i kredive joperformuese shënoi rënie në 4.9 përqind, një shkallë e ulët krahasuar me vendet në rajon (figura 32). Për më tepër, niveli i mbulueshmërisë së

kredive joperformuese me provizione shënoi rritje në 126.5 përqind.

Kjo ndihmoi edhe në rritjen e mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione, që shënoi rritje në 122.1 përqind.


Figura 32. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve



Burimi: BQK (2017)

Sektori bankar vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit në 17.9 përqind në dhjetor 2016. Treguesi i likuiditetit shënoi rënie në krahasim me vitin paraprak, si pasojë e zbatimit të normës negative të interesit në rezervat e mbajtura nga bankat komerciale në BQK mbi rezervën e detyrueshme, e që rrjedhimisht ndikoi në zvogëlimin e shumës së parasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, sektori bankar vazhdon të shfaqë pozicion të kënaqshëm të likuiditetit (figura 33).

Figura 33. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës



Burimi: BQK (2017)

Në vitin 2016, sektori bankar shënoi rënie të profilit si pasojë e zvogëlimit të të hyrave dhe rritjes së shpenzimeve. Niveli i kredive joperformuese vazhdoi të përcjellë trend rënës, duke arritur normën më të ulët të kredive joperformuese në krahasim edhe me vendet në Ballkanin Perëndimor. Për më tepër, sektori bankar vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit dhe pozicion të kënaqshëm të likuiditetit.


Sektori pensional

Sektori pensional shënoi rritje vjetore të theksuar të aseteve prej 15.2 përqind. Vlera e përgjithshme e aseteve të sektorit pensional për vitin 2016 arriti në 1.43 miliard euro, që e bënë sektorin e dytë më të madh në sistemin financiar me 26.5 përqind të aseteve (figura 34). Rritja e aseteve të sektorit pensional kryesisht mund t'i atribuohet rritjes së kontributeve të reja dhe kthimit në investime gjatë kësaj periudhe.

Vlera e arkëtimeve të reja arriti në 152.0 milionë euro (138.0 milionë euro në 2015), që paraqet rritje vjetore prej 10.2 përqind. Vlera e arkëtimeve të reja të Fondit të Kursimeve Pensionale

të Kosovës (FKPK-së) arriti në 151.5 milionë euro, ndërsa ajo e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP-së) arriti në 496.5 mijë euro.

Figura 34. Asetet e sektorit pensional, në milionë euro




Burimi: BQK (2017)

Sektori pensional dyfishoi kthimin në investime duke arritur në 65.3 milionë euro, për dallim nga kthimi prej 29.7 milionë euro në vitin paraprak. FKPK realizoi kthim pozitiv në investime prej 64.6 milionë euro, ndërsa FSKP 704.7 mijë euro. Tregjet u karakterizuan me lëkundje të theksuara këtë vit kryesisht për shkak të normave të ulëta të interesit në investime, pasigurisë rreth daljes së Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian dhe pritjes për ndryshime të politikës monetare nga ana e Sistemit të Rezervës Federale. Përkundër këtyre zhvillimeve, strategjia investuese e fondeve pensionale rezultoi në këtë amortizuar luhatjet dhe të ketë siguruar rritje të vlerës së kthimit.

FKPK, që përbën 99.5 përqind të aseteve të sektorit pensional, ndërroi strategjinë investive në krahasim me vitin e kaluar, duke u orientuar në investimet jashtë vendit. Investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës shënuan rënie prej 12.2 përqind, ndërsa investimet në fondet e

përbashkëta investive, që janë jashtë vendit, shënuan rritje prej 20.2 përqind (figura 35).

Figura 35. Investimet e FKPK-së



Burimi: FKPK (2017)

Sektori pensional gjatë vitit 2016 shënoi rritje të theksuar vjetore të aseteve. Kthimi pozitiv në investime si dhe rritja e kontributeve të reja ishin dy faktorët kryesorë që ndikuan në këtë rritje. FKPK zhvendosi investimet nga ato në Obligacione Qeveritare të Republikës së Kosovës kundrejt investimeve në fondet e përbashkëta investuese jashtë vendit.


Sektori i sigurimeve

Sektori i sigurimeve, që përfaqëson rreth 3.0 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar, në dhjetor 2016 shënoi rritje vjetore prej 6.1 përqind (figura 36). Një ndër kontribuesit kryesor në rritjen e aseteve të sektorit të sigurimeve ishte rritja e parave të gatshme të mbajtura në bankat komerciale, që ka pjesëmarrjen më të madhe në strukturën e aseteve të kompanive të sigurimit.

Sigurimet jo-jetë, të cilat përfaqësojnë pjesën më të madhe të sektorit me 89.9 përqind të gjithsej aseteve, shënuan rritje vjetore prej 5.8 përqind. Ndërsa,

sigurimet 'jetë', që përbëjnë pjesën e mbetur të aseteve, shënuan rritje vjetore prej 8.3 përqind.

Figura 36. Asetet e sektorit të sigurimeve




Burimi: BQK (2017)

Gjatë vitit 2016, vlera e primeve të shkruara nga kompanitë e sigurimeve arritën vlerën prej 83.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.4 përqind. Struktura e primeve të shkruara kryesohet nga primet e sigurimit jo-jetë të cilat përfaqësojnë 96.9 përqind të gjithsej primeve të shkruara. Vlera e realizuar e primeve të shkruara nga sigurimi jo-jetë arriti në 80.9 milionë euro në vitin 2016, që tregon për një rritje vjetore prej 4.7 përqind. Ndërsa, vlera e primeve të shkruara nga sigurimi jetë arriti vlerën 2.6 milionë euro, duke shënuar një rënie vjetore prej 3.7 përqind.

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e kompanive të sigurimit dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan rritje vjetore prej 3.8 përqind (rritje prej 15.1 përqind në vitin 2015).

Figura 37. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK (2017)

Ritja më e vogël e dëmeve të paguara gjatë kësaj periudhe krahas rritjes më të lartë të primeve të shkruara, rezultoi në rënie të lehtë të raportit të gjithsej dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara (figura 37).

Performanca e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve u karakterizua me thellim të humbjes në vitin 2016 kundrejt vitit paraprak. Të hyrat neto të sektorit të sigurimeve në dhjetor 2016 shënuan rritje vjetore prej 1.3 përqind, përderisa shpenzimet shënuan rritje vjetore prej 10.8 përqind. Rritja më e lartë e shpenzimeve rezultoi në humbje të regjistruar nga sektori i sigurimeve gjatë kësaj periudhe prej 23.9 milionë euro (humbje prej 8.9 milionë në dhjetor 2015).⁶ Thellimi i humbjes ishte rrjedhojë e humbjes së shënuar në kuadër të sigurimit 'jo-jetë' (humbje prej 24.3 milionë euro), përderisa performanca financiare e sigurimit 'jetë' ishte pozitive (fitim në vlerë prej 364.6 mijë euro). Humbjet e sigurimit 'jo-jetë' kryesisht i atribuohen rritjes së theksuar të shpenzimeve për provizionet teknike,

⁶ Bazuar në të dhënat e paaudituar.

rezervave për dëmet e raportuara dhe rezervat për dëmet e ndodhura por jo të raportuara.

Rritja vjetore e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj prej 2.1 përqind, krahas rritjes së konsiderueshme prej 29.0 përqind e rezervave teknike të sektorit të sigurimeve ndikuan në përkeqësimin e nivelit të likuiditetit. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave zbriti në 74.8 përqind në dhjetor 2016 (94.5 në dhjetor 2015), përderisa raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve u zvogëluua në 68.7 përqind (85.2 në dhjetor 2015).


Sektori i sigurimeve në dhjetor 2016 shënoi rritje të aseteve. Megjithatë, performanca financiare e këtij sektori vazhdoi të përkeqësohet, duke u karakterizuar me thellim të humbjes si pasojë e mjeteve të ndara për mbulimin e dëmeve.

Sektori mikrofinanciar

Asetet

Gjatë vitit 2016 asetet e sektorit mikrofinanciar arritën në 148.2 milionë euro, duke shënuar rritje të theksuar vjetore prej 23.7 përqind (figura 38).

Figura 38. Asetet e sektorit mikrofinanciar (milionë euro)




Burimi: BQK (2017)

Kontribuues kryesorë në rritjen e aseteve të sektorit ishte rritja e kredive bruto, që kryesisht financohet nga huamarrjet në sektorin e jashtëm. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar vazhdon të dominohet nga kreditë bruto (73.5 përqind), pasuar nga lizingjet (15.2 përqind).

Kreditë

Aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar gjatë vitit 2016 shënoi përmirësim të theksuar, ku vlera e kredive shënoi rritje vjetore prej 32.2 përqind (figura 39).


Figura 39. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive



Burimi: BQK (2017)

Ekonomitë familjare, që kanë një pjesëmarrje prej 67.0 përqind në gjithsej kreditë e sektorit, u karakterizuan me rritje vjetore prej 35.7 përqind. Gjithashtu, kreditë ndaj ndërmarrjeve, që përfaqësojnë 33.0 përqind të gjithsej kredive të sektorit, shënuan një rritje vjetore prej 22.7 përqind.

Figura 40. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2017)


Sa i përket kredive të lëshuara ndaj sektorëve ekonomik, bujqësia shënoi rritjen më të lartë vjetore, pasuar nga ndërtimtaria dhe sektorët tjerë. Tregtia është i vetmi sektor që u karakterizua me rënie të kreditimit (figura 40).

Lizingjet

Lizingjet shënuan rritje vjetore prej 3.4 përqind në vitin 2016, kundrejt rënies së shënuar në vitin paraprak prej 2.5 përqind (figura 41).

Në rritjen e lizingjeve kontribuoi rritja e lizingjeve hipotekare dhe 'lizingjeve tjera', që shënuan rritje vjetore prej 6.0 përkatësisht 6.8 përqind.

Figura 41. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar (përqindje)




Burimi: BQK (2017)

Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar në dhjetor 2016 vazhdoi të përcjellë trendin rënës, duke rënë në 21.3 përqind. Për të dy kategoritë, gjegjësisht, norma e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve u karakterizua me rënie të njëjtë prej 0.9 pikë përqindje (figura 42).

Figura 42. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2017)

Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i shërbimeve rezulton të ketë normën më të ulët të interesit në kredi. Ndërsa, sektori i industrisë

vazhdon të ketë normën më të lartë të interesit në kredi (figura 43).

Figura 43. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2017)

Performanca e sektorit mikrofinanciar

Deri në dhjetor 2016, sektori mikrofinanciar realizoi profit në vlerë prej 4.1 milionë euro, që përbën një rritje të konsiderueshme vjetore prej 73.3 përqind. Rritja më e lartë e të hyrave (kryesisht e atyre nga interesi) krahas rritjes së shpenzimeve ndikoi në realizim më të lartë të profitit të sektorit në këtë periudhë (figura 44).


Figura 44. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2017)

Si rrjedhojë e performancës pozitive financiare gjatë vitit 2016, treguesit e profitabilitetit shënuan përmirësim (figura 45).


Figura 45. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2017)

Niveli i kredive joperformuese në raport me gjithsej kreditë në dhjetor 2016 u zvogëlua për 1.3 pikë përqindje në krahasim me vitin paraprak në 2.9 përqind, nivel ky më i ulëti në vitet e fundit (figura 46). Për më tepër, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizioneve shënoi rritje të theksuar në 200.2 përqind, ndikuar kryesisht nga rënia e vlerës së kredive joperformuese (figura 46).

Figura 46. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



Burimi: BQK (2017)

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me përshpejtim të theksuar të rritjes së aseteve në vitin 2016. Gjithsej kreditë vazhduan të shënojnë rritje, përderisa norma mesatare e interesit përcjelli trend rënës. Sektori shënoi rritje të theksuar të profitit, përderisa edhe cilësia e portofolit kreditor u përmirësua dukshëm.

Tregu i letrave me vlerë

Sipas kalendarit të publikuar nga Ministria e Financave, në vitin 2016 numri i ankandeve për emetimin e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës arriti në 19. Vlera e shpallur në ankande ishte 420.0 milionë euro.

Gjatë vitit 2016, Qeveria e Kosovës ka shpallur vlerë dhe numër më të vogël të bonove të thesarit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ndërsa, përderisa numri i fletë-obligacioneve mbeti i pandryshuar nga viti paraprak, vlera e tyre ishte më e lartë (tabela 2). Sa i përket shumës së emetuar, ajo mbeti e njëjtë me vlerën e shpallur si për bono të thesarit ashtu edhe për fletë-obligacione.

Tabela 2. Numri dhe vlera e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës


Periudha	Numri i bonove të thesarit	Vlera e pranuar e bonove të thesarit	Numri i fletëobligacioneve	Vlera e pranuar e fletëobligacioneve
Janar-Dhjetor 2013	21	308.20	-	-
Janar-Dhjetor 2014	17	345.02	4	52.00
Janar-Dhjetor 2015	14	278.60	7	119.95
Janar-Dhjetor 2016	12	260.00	7	160.00

Burimi: MF (2017)

Sipas afatit të maturimit, struktura e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës vazhdon të tregojë tendencë të zhvendosjes nga letrat me vlerë me maturitet afatshkurtër në letra me vlerë me maturitet afatgjatë.

Kategoria kryesore në strukturën e letrave me vlerë vazhdon të mbetet ajo e bonove të thesarit me afat maturimi 364 ditë, pasuar nga fletë obligacionet me afat maturimi dy vite (figura 47).


Figura 47. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: BQK (2017)

Shuma e ofertuar nga pjesëmarrësit tejkaloi shumë e shpallur në ankande nga Ministria e Financave për 2.17 herë (1.58 në dhjetor 2016). Krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2016 është vënë re një rritje e ofertës dhe njëkohësisht rritje e emetimit të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Figura 48. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2017)

Në vitin 2016, norma mesatare e interesit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës ka

shënuar rënie në 0.79 përqind (1.94 përqind në vitin 2015). Në këtë periudhë, normat e interesit për të gjitha afatet e maturimit ishin më të ulëta krahasuar me vitin 2015.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2017): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 17 TM4 2016, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2017):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <http://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2017):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat ë tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2017): Metal Prices database.

FAOUN (2017): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations:
<http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2017): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2017): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	2015	2016
Sektori real 1/		
PBB (në milionë euro)	5,807.1	5,984.6
Çmimet (mesatarja vjetore)	-0.5%	0.3%
Çmimet (fondi i periudhës)	-0.2%	1.3%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat (në milionë euro)	1,456.8	1,596.5
Shpenzimet (në milionë euro)	1,568.2	1,657.6
Bilanci primar (në milionë euro)	-111.4	-61.1
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	4,895.3	5,371.4
prej të cilave: Bankat	3,385.3	3,636.8
Kredi	2,019.5	2,230.0
Depozita	2,702.9	2,897.9
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	7.7	7.2
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.2	1.2
Hendeku i normës së interesit	6.5	6.0
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-471.4	-534.6
prej të cilave: remitencat e pranuar	665.5	691.0
Llogaria financiare	-275.7	-120.3
Investimet e huaj direkte në Kosovë	308.8	215.9
Investimet portfolio, net	48.8	370.2
Investimet tjera, net	-146.3	-238.5
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve, net	-17.5	1.1
Asetet	4,391.5	4,667.3
Detyrimet	4,409.0	4,666.2
Borxhi i jashtëm, gjithsej	1,931.8	2,045.0
Borxhi i jashtëm privat	1,490.0	1,600.4
Borxhi i jashtëm publik	441.8	444.6

Burimi:

1/ ASK (2017).

2/ MF (2017).

3/ BQK (2017).

